E ARDHMJA E LETËRSISË SHQIPE: NGA LETËRSIA E BAZUAR NË MORALIN E SKLLAVIT DREJT LETËRSISË SË BAZUAR NË MORALIN E MJESHTRIT

Alesia **XHOGU**

Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës, Shqipëri, ale.sia13@hotmail.com

Unë pranoj që abstrakti im i pranuar të publikohet në faqen zyrtare të internetit / revistën e përcaktuar nga organizatorët: Po Jo

Abstrakt

Detyra e artit është të shuajë etjen e shpirtit, dhe letërsia, si formë arti, duket se e ka humbur shtegun e saj. Qëllimi i këtij kërkimi shkencor është të krahasojë letërsinë shqiptare para viteve ’90 me atë të sotmen. Dy sisteme politike krejtësisht të ndryshme, si ai komunist dhe ai demokratik, në dukje kanë prodhuar të njëjtin model letrar: letërsinë e bazuar në moralin e skllavit. Megjithatë, në pesë vitet e fundit po shfaqet një prirje e re.

Letërsia e bazuar në moralin e mjeshtrit, përfaqësuar nga librat motivues, po fiton terren sidomos tek të rinjtë. Kjo prirje shënon një ndryshim të dukshëm: një largim nga letërsia e ideologjizuar e së kaluarës drejt një letërsie që ushqen zhvillimin personal dhe nevojën shpirtërore.

Në këtë kërkim është përdorur metoda krahasimore përmes dy anketave: njëra iu drejtua 15 mësuesve, pedagogëve dhe shkrimtarëve që kanë përjetuar sistemin komunist, ndërsa tjetra 50 të rinjve që përfaqësojnë një brez të lirë në zgjedhje.

Rezultatet tregojnë se të rinjtë po i drejtohen librave motivues si një mjet i rritjes personale dhe shpirtërore, jashtë kornizave ideologjike dhe dogmave. Ky fenomen shtron pyetje të reja për të ardhmen e letërsisë shqiptare dhe rolin e saj në një shoqëri që synon emancipimin individual dhe kolektiv.

Fjalë kyçe: Letërsi, filozofi, shoqëri, mendësi, spiritualizëm

Referencat

Fromm, E. (2009). Gjuha e harruar (Përkth. F. Dibra). Tiranë: Fan Noli.

Hesse, H. (2010). Loja e rruazave prej qelqi (Përkth. A. Ristani). Tiranë: Elena Gjika.

Kabo, P. (2014). Antropologjia e shpirtit. Tiranë: Onufri.

Kadare, I. (2012). Mosmarrëveshja. Tiranë: Onufri.

Marko, P. (2001). Çuka e shtegtarit. Tiranë: Omsca-1.

Nietzsche, F. (2004). Agu i mëngjesit (Përkth. T. Hatia). Tiranë: Uegen.

Nietzsche, F. (2012). Njerezor, teper njerezor (Përkth. T. Hatia). Tiranë: Uegen.

Hyrje

Qëllimi i këtij kërkimi shkencor është të hedhë dritë mbi fenomenin e ri-rendja e të rinjve pas librave motivues- duke analizuar shkaqet e krijimit të këtij fenomeni. Letërsia e bazuar në moralin e skllavit i referohet letërsisë së realizmit socialist si një injektim nga jashtë brenda ndërsa letërsia e bazuar në moralin e mjeshtrit i referohet zhanerit modern të zhvillimit intuitiv dhe brendësor të njeriut. Ky punim u ngjiz nga: denoncimi ndaj letërsisë së motivuar nga periudha komuniste, reflektimet filozofike, nxitur prej intuitës dhe si detyrim të diktuar nga profesioni im si mësuese e gjuhës angleze, dhe mori trajtën e një kërkimi shkencor me anë të metodologjisë cilësore-krahasimore: Metoda krahasimore e përdorur në këtë kërkim shkencor është krahasimi empirik nëpërmjet dy anketave të realizuara: Anketë drejtuar 15 mësuesve/pedagogëve dhe shkrimtarëve si përfaqësues të një gjenerate e cila e ka jetuar sistemin komunist dhe anketë drejtuar 50 të rinjve si përfaqësues të një gjenerate e cila sintetizon dijen dhe lirinë e zgjedhjes. Nga përgjigjet e marra vihet re prirja e të rinjve drejt librave motivues si një çelës i cili i siguron zhvillimin dhe suksesin individual e parë në spektrumin e një nevoje shpirtërore jodogmatike.

Historiku i shkurtër politiko-kulturor i Shqipërisë

Shqipëria, shtet i Europës Juglindore, e cila shtrihet në pjesën jugperëndimore të gadishullit Ballkanik, përtej pozicionit të saj strategjik dhe pasurisë natyrore që posedon, ka luajtur rolin e saj historik dhe kulturor në lëmin e dijes. E mbingarkuar me pushtime të shumta, ka mundur të shpërndajë rrezet e saj të dijes në atdhe, Europë dhe jo vetëm, nëpërmjet figurave të rëndësishme si: Gjergj Fishta, Naim Frashëri, Eqerem Çabej, Ernest Koliqi, Fan Noli, Ismail Kadare e shumë të tjerë. Një hero si Gjergj Kastriot Skënderbeu, i vlerësuar nga Europa, por i tradhtuar nga nipi i tij Hamzai. Një figurë si Ismail Qemali, i vlerësuar si personalitet nga Europa, por e kundërta ndodhte me shtetin e tij. Një shkrimtar pretendent për çmim Nobel si Ismail Kadare, por i tradhtuar nga vetë populli i tij. Këto fakte të dokumentuara mund të jenë një etalon matës për studimin antropologjik të shtetit shqiptar. “E shkuara është prolog” – thotë Shekspiri, e kjo e shkuar e çuditshme e Shqipërisë hibride ka bërë të mundur këtë

transformim të sistemit arsimor të ditëve të sotme. E poshtëruar nga shtetet fqinje, si rasti i studentëve e akademikëve shqiptarë, siç dëshmohet në librin “I izoluar”, botuar në Prishtinë më 2009, të cilët në dhomat e torturave përjetonin vuajtjet e ferrit nën britmat: “Qenkeni me prejardhje ilire, hë?”, “Ju duket vetja të fismë, hë?”, “Na këtë kamzhik për zanafillën tënde. Na dhe këtë për nënën shqiptaro-ilire që të ka pjellë.”E deri në atë periudhë të errët diktatoriale ku të shumtë kanë qenë shkrimtarët që e kanë përshkruar, nevojitet një rishikim i fakteve historike, për hir të konvertimit të popullit shqiptar në mendësi perëndimore.Njëri syresh, Petro Marko, i cili shprehej kështu për sistemin diktatorial: “Një makinacion mefistofelik i cili ngjall tmerr dhe terror”, nëpërmjet artit të tij i ka dhuruar të ardhmes një copëz pasqyrimi të periudhës së komunizmit. (Marko 2001)

Komunizmi, regjimi ku lufta ishte paqe, barazia ishte e barasvlefshme me varfërinë, arsimi i rrënuar, kontroll paranojak, shkurtimi/tkurrja e gjuhës shqipe, mungesa e lirisë së mendimit e të veprimit për 50 vjet me radhë, ka shpëlarë trurin e një populli të tërë.Kjo makinë shpëlarëse i ka rrënjët aq të thella sa edhe sot e kësaj dite pasojat e këtij regjimi ndihen ende.Mohimi i së shkuarës ishte një ndër parimet e komunizmit, i cili vihet re në asgjësimin e religjioneve dhe jo vetëm, e ndaj sot kemi të tashmen, e cila, përpara se të kthehet në të shkuar, ja vlen të studiohet.

Çfarë është edukimi

"Fjala "edukim" i ka rrënjët në gjuhët proto-indiane-evropiane, në fjalën deuk. Fjala erdhi në latinisht në dy forma: educare, që do të thotë "të ushqesh" ose "të rritësh" dhe educatus, që përkthehet si edukim. Në anglishten e mesme ajo ishte edukuar, përpara se të ndryshonte në formën e saj aktuale. Arsimi filloi si përgjigje e natyrshme e qytetërimeve të hershme ndaj luftës për të mbijetuar dhe lulëzuar si kulturë. Të rriturit trajnuan të rinjtë e shoqërisë së tyre në njohuritë dhe aftësitë që do t'u nevojiteshin për të zotëruar dhe përfundimisht për t'i përcjellë.Evolucioni i kulturës dhe i qenieve njerëzore si specie varej nga kjo praktikë e transmetimit të njohurive. Në shoqëritë parashkolluese kjo arrihej gojarisht dhe me imitim. Tregimi i tregimeve vazhdoi nga një brez në tjetrin. Gjuha gojore u zhvillua në simbole dhe shkronja të shkruara. Thellësia dhe gjerësia e njohurive që mund të ruheshin dhe kalonin shpejt u rritën në mënyrë eksponenciale. Kur kulturat filluan të zgjerojnë njohuritë e tyre përtej aftësive bazë të komunikimit, tregtisë, mbledhjes së ushqimit, praktikave fetare, e kështu me radhë, arsimimi formal dhe shkollimi, përfundimisht pasuan. Shumë nga sistemet e para arsimore u bazuan në shkollimin fetar. Kombi i Izraelit në shek. 1300 p.e.s., ishte një nga të parët

që krijoi një sistem shkollimi me miratimin e Tevratit. Në Indi, sistemi i arsimit Gurukul mbështeti shkollat tradicionale të të mësuarit rezidenciale hindu; zakonisht shtëpia e mësuesit ose një manastir ku mësuesi jepte njohuri për Fenë, Shkrimet, Filozofinë, Letërsinë, Luftën, Mjekësinë, Astrologjinë dhe Historinë (fjala sanskrite "Itihaas" do të thotë Histori). Ndryshe nga shumë rajone të botës, arsimi në Kinë filloi jo me fe të organizuara, por bazuar në leximin e teksteve klasike kineze, të cilat u zhvilluan gjatë periudhës perëndimore Zhou.Ky sistem edukimi u zhvillua më tej nga shteti i hershëm kinez, i cili varej nga zyrtarë të arsimuar dhe të arsimuar për funksionimin e perandorisë dhe një sistem perandorak provimi u krijua në Dinastinë Han (206 p.e.s.-220) për vlerësimin dhe përzgjedhjen e zyrtarëve. Ky sistem i bazuar në merita krijoi shkolla që mësuan klasikët dhe vazhduan të përdoren për 2000 vjet. Ndoshta ndikimi më i rëndësishëm në sistemin arsimor perëndimor ishte Greqia e Lashtë. Mendimtarë të tillë si Sokrati, Aristoteli dhe Platoni së bashku me shumë të tjerë, prezantuan ide të tilla si mendimi racional, kërkimi shkencor, humanizmi dhe natyralizmi.Megjithatë, si pjesa tjetër e botës, edhe institucionet fetare luajtën një faktor të madh. Sistemet moderne të arsimit në Evropë e kanë origjinën nga shkollat e periudhës mesjetare.Shumica e shkollave gjatë kësaj epoke u themeluan mbi parimet fetare me qëllimin e vetëm të trajnimit të klerit. Shumë nga universitetet më të hershme, si Universiteti i Parisit, i themeluar në 1150 kishin një bazë të krishterë. Përveç kësaj, ekzistonin një numër universitetesh laike, si Universiteti i Bolonjës, i themeluar në 1088. " (bazat teorike te mesimdhenies lek.1)

Filozofia e edukimit

"Filozofia e edukimit është studimi i qëllimit, natyrës dhe përmbajtjes ideale të edukimit. Temat e ndërlidhura përfshijnë vetë njohurinë, natyrën e mendjes njohëse dhe subjektit njerëzor, problemet e autoritetit dhe marrëdhëniet midis arsimit dhe shoqërisë. Të paktën që nga koha e John Locke, filozofia e edukimit ka qenë e lidhur me teoritë e psikologjisë së zhvillimit dhe zhvillimit njerëzor. Qëllimet themelore që janë propozuar për arsimin përfshijnë: Ndërmarrja e shoqërisë civile varet nga edukimi i të rinjve për t'u bërë qytetarë të përgjegjshëm, të menduar dhe iniciativë. Kjo është një detyrë e ndërlikuar, sfiduese që kërkon kuptim të thellë të parimeve etike, vlerave morale, teorisë politike, estetikës dhe ekonomisë,

për të mos përmendur të kuptuarit se kush janë fëmijët, në vetvete dhe në shoqëri. Përparimi në çdo fushë praktike varet nga të pasurit e kapaciteteve që mund të edukojë shkollimi.Arsimi është kështu një mjet për të nxitur zhvillimin dhe prosperitetin e ardhshëm të individit, shoqërisë, madje edhe njerëzimit. Theksi shpesh vihet në suksesin ekonomik në këtë drejtim. Zhvillimi individual dhe aftësia për të përmbushur qëllimet e veta mund të varen nga një përgatitje adekuate në fëmijëri. Kështu, arsimi mund të përpiqet të japë një themel të fortë për arritjen e përmbushjes personale. Sa më i mirë të jetë themeli që ndërtohet, aq më i suksesshëm do të jetë fëmija.Bazat e thjeshta në arsim mund ta çojnë një fëmijë larg. Një parim qendror i arsimit zakonisht përfshin "dhënien e njohurive".Në një nivel shumë themelor, ky qëllim ka të bëjë përfundimisht me natyrën, origjinën dhe shtrirjen e njohurive. Dega e filozofisë që trajton këto dhe çështje të ngjashme njihet si epistemologji. Kjo fushë studimi shpesh fokusohet në analizimin e natyrës dhe shumëllojshmërisë së njohurive dhe se si ajo lidhet me nocione të ngjashme si e vërteta dhe besimi.Teksa fjala DITURI përdoret shpesh për të përcjellë këtë qëllim të përgjithshëm të edukimit, ai mund të shihet gjithashtu si pjesë e një vazhdimësie të njohurive që variojnë nga të dhëna shumë specifike deri në nivelet më të larta. Parë në këtë këndvështrim, vazhdimësia mund të mendohet se përbëhet nga një hierarki e përgjithshme e niveleve të mbivendosura të njohurive. Nxënësit duhet të jenë në gjendje të lidhin informacion të ri me një pjesë të informacionit të vjetër për të qenë më në gjendje të mësojnë, kuptojnë dhe ruajnë informacionin. Kjo vazhdimësi mund të përfshijë nocione të tilla si të dhëna, informacion, njohuri, mençuri dhe realizim.Edukimi është një proces që fillon që në lindje dhe vazhdon deri në fund të jetës. Faza e hershme e jetës është shumë e rëndësishme pasi kjo periudhë ndikon në procesin e mëposhtëm. Megjithatë, ne nuk jemi në gjendje të kontrollojmë plotësisht fazën e hershme, sepse fëmijët mbeten nën kujdesin e familjeve të tyre derisa të fillojnë të ndjekin shkollën. Edhe nëse fëmijët studiojnë në shkolla, shumë faktorë si miqtë brenda dhe jashtë shkollës ndikojnë në procesin e tyre arsimor. Sistemi arsimor fokusohet tek fëmijët nga parashkollori deri në arsimin pasuniversitar. Përfitimet arsimore kryesisht zhvendosen nga përfitimet publike në ato individuale pasi ata ndjekin një nivel më të lartë të shkollës çdo vit. Prandaj arsimimi është i detyrueshëm në 10 apo 12 vitet e para për fëmijët.Përndryshe, do të ndodhnin probleme sociale më të mëdha dhe më të kushtueshme nëse ne nuk mund t'i edukonte ata të ishin qytetarë të mirë." (bazat teorike te mesimdhenies lek.1)

Edukimi sot

Epoka të ndryshme prodhojnë gjenerata me mendësi të ndryshme. Nëse dikur edukimi përjetohej si një mision shpirtëror dhe intelektual, sot ai shpesh reduktohet në një mekanizëm burokratik që prodhon diploma. Ky transformim i qëllimit të arsimit reflekton një ndryshim më të thellë: kalimin nga morali i mjeshtrit, që ushqen krijimtarinë dhe përgjegjësinë personale ndaj dijes, në moralin e skllavit, ku individi kërkon miratim të jashtëm dhe sukses formal. Nëse krahasojmë arsimin shqiptar të dikurshëm me atë të sotmin, dallojmë se qëllimi i shumicës së të rinjve nuk është më përvetësimi i dijes si vlerë, por përfitimi i diplomës si status. Demokracia, në trajtën e saj të sipërfaqshme, ka demokratizuar institucionet arsimore, por shpesh në dëm të cilësisë së përmbajtjes. Standardizimi i kurrikulave, i justifikuar në emër të "barazisë", ka zbehur dimensionin e përvojës individuale dhe krijuese të dijes — thelbi i moralit të mjeshtrit. Kam prirje kundërshtie ndaj këtij demokratizimi uniformues, pasi dijen e konsideroj një imperativ kategorik, jo një e drejtë e barabartë për të gjithë në nivelin e saj më të lartë, por një përgjegjësi individuale për ta tejkaluar vetveten. Ndryshe nga fryma e kulturës gjermane, ku racionaliteti dhe logjika janë virtyte të rrënjosura, mendësia shqiptare mbetet e ndikuar nga një psikologji lindore e nënshtrimit — e afërt me moralin e skllavit që Nietzsche e përkufizonte si moral të vartësisë dhe fajit. Sot lobohet çdo ditë për demokraci dhe liri të individit, por kjo liri shpesh përkthehet në mungesë detyrimi dhe disipline. Studenti modern pretendon për notë të mirë, por jo për përkushtim të vërtetë. Kështu, dijes i hiqet karakteri i saj iniciatik: ajo nuk përjetohet si rrugëtim drejt mjeshtërisë së brendshme, por si objekt tregtar që mund të blihet me minimumin e përpjekjes. Në këtë kuptim, arsimi shqiptar ndodhet në një fazë tranzicioni moral, ku duhet të çlirohet nga logjika e skllavit — nga nënshtrimi ndaj formës dhe autoritetit — dhe të rikthejë moralin e mjeshtrit: atë të njeriut që e sheh dijen si një akt krijimi, jo si një dëshmi posedimi. Tendenca e obskurantizmit ka zënë një përqindje të lartë në mesin e të rinjve, të cilët shpesh i japin përparësi parave dhe punëve të rastit mbi zhvillimin intelektual. Në këtë epokë kapitaliste, slogani i pashpallur "Unë zotëroj para, pra unë kam të drejtë" është bërë aksioma e re morale. Ky është një shenjë e qartë e moralit të skllavit, që i nënshtrohet forcës materiale dhe autoritetit të jashtëm, duke humbur aftësinë për gjykim të lirë e krijues. Kur kapitali udhëheq pa mendim, ai nuk krijon progres, por një shoqëri analfabete, konsumatore dhe të degraduar shpirtërisht. Arsimi është i shenjtë dhe nuk duhet të njolloset nga mediokriteti. Raporti kurrikulë–pedagog–student duhet të jetë një unitet organik, ku secila hallkë e sistemit ushtron përgjegjësi ndaj dijes dhe jo ndaj interesit. Një liri pa rregulla është anarki, dhe kur kjo ndodh në arsim, ajo përkthehet në kaos kulturor dhe moral — në një brez që nuk di pse mëson, pse beson dhe pse krijon. Krahasimi ndërmjet arsimit të dikurshëm dhe atij

të sotëm bëhet i domosdoshëm për të rikthyer në ndërgjegje figurën e njeriut të dijes, atij që e shihte arsimin si mision kombëtar dhe jo si instrument përfitimi. Jetojmë në një epokë ku festojmë Alfabetin pa njohur historinë e tij, ku të rinjtë festojnë fetë pa kuptuar domethënien e tyre, thjesht si rit tradicional. Ky është një shembull i humbjes së mendimit kritik dhe hulumtimit personal, i cili është thelbi i moralit të mjeshtrit. Në institucionet arsimore po shfaqet një censurë e padukshme që pengon debatin dhe mendimin e lirë, sidomos në tema me natyrë religjioze apo filozofike. Kështu, universiteti — shtëpia e dijes — rrezikon të shndërrohet në shtëpi dogmash. Nuk është e pranueshme që nga një akademik të dëgjosh shprehje të tilla si “Dua të jeni njerëz të mirë, nëna të mira”, kur auditori është laik dhe kërkon ushqim intelektual, jo moralizim tradicional. Po ashtu, është e papranueshme të thuhet “Gjej një zanat më mirë” nga një pedagog që duhet të kultivojë mendim e jo të shkurajojë pasionin për dijen. Këto raste tregojnë se roli i pedagogut është keqinterpretuar. Ai nuk duhet të jetë predikues i konformizmit, por nxitës i emancipimit mendor. Siç vëren akademiku Artan Fuga, arsimi shqiptar është ende larg standardeve të Perëndimit — jo për mungesë burimesh, por për mungesë vizioni filozofik. Të njëjtin shqetësim e ndan edhe filozofi Përparim Kabo, një emër që fatkeqësisht shumë të rinj nuk e njohin, çka dëshmon shkëputjen e brezave nga tradita e mendimit të thellë shqiptar. Në këtë kuptim, letërsia dhe arsimi shqiptar ndodhen në të njëjtën nyje morale: përballë zgjedhjes nëse do të mbeten të nënshtruar ndaj moralit të skllavit — ku fjala, ideja dhe dija janë mjete për status — apo do të kalojnë në moralin e mjeshtrit, ku dija bëhet rrugëtim i brendshëm, akt i lirisë dhe krijimit. Vetëm në këtë mënyrë mund të lindë një letërsi e ardhshme shqiptare që nuk i bindet formave, por shpirtit të saj krijues.

Arti si çështje hyjnore

Ismail Kadare ka thënë: “Të shkruaje në diktaturë ka qenë e vështirë, thuajse e pamundur. E pamundur të shkruaje siç dëshiroje të shkruaje. Ja përse unë i jam mirënjohës letërsisë: Letërsia më dha mundësinë të kapërceja të pamundurën. Ferri komunist, si çdo ferr tjetër, është mbytës në kuptimin më të keq të fjalës. Por, letërsia arrin ta transformojë atë në një forcë jete, në një forcë mbi të cilën mbështetesh për të mbijetuar, për të mundur me kokën lart çdo gjë.” Ndiej keqardhje për të shumtën herë mundësi të dhënë literaturës shqipe, pasi zhgënjim pas zhgënjimi e mundësi pas mundësie, si një rreth ciklik i pashtershëm, konkluzioni vërtitet rreth së njëjtës gjë. Ndonëse mundohem ta mirëkuptoj e në të njëjtën kohë e përçmoj, regresi i kombit tonë, me keqardhje më duhet ta them, e largon lexuesin nga literatura shqipe. I falemi të parëve tanë sërish e sërish. I rikthehemi figurave të shquara sërish e sërish, me shpresën e vetme të

rikthimit nën dritën e diellit, të vetmes, të vërtetës, me qëllimin universal, të civilizimit dhe të konvertimit të shoqërisë sonë në shoqëri perëndimore dhe frytdhënëse. Ndonëse e kuptoj misionin sublim, bie shpesh herë në vorbullën e errët të nihilizmit që të shkakton arsyeja e fillim-përmendur, shtimi i veprave letrare në pothuajse unanime në tematikën e vetme: regresioni. “Shqipëria u krijua nga Zoti, shpëtoi nga rastësia dhe u vra nga politikanët”, tha i madhi Faik Konica. Mos ndoshta kemi nevojë për një katarsis kolektiv? Apo mos ndoshta kemi harruar të argëtojmë shoqërinë nëpërmjet literaturës fantastike-shkencore? Është i çuditshëm fakti se si një individ mund të adhurojë një shkrimtar të atdheut të tij, e më pas teksa ky shkrimtar përshkruan atdheun, pa dashur, e jo për faj të tij, magjia e tij prishet. Vuajtje-ankesat janë tanimë refren i literaturës sonë. Mesa duket kemi prirje mazokiste! Është e vështirë të lësh atdheun tënd, por akoma më e vështirë ta pranosh atë, ndoshta për faktin e vetëm, disi konspirativ (por edhe faktik), i cili na ka shpëlarë trurin me pallavra të llojit tallava, duke mohuar historinë e te parëve tanë. Ata nuk janë kujtuar kurrë! Sa prej nesh e dinë prejardhjen e alfabetit shqiptar në raport me festuesit e kësaj dite kombëtare? Sa prej nesh e dinë historinë e kulluar, të padeformuar e të pacenuar në raport me sharlatanët që vërtiten në çdo cep të këtij kombi, duke shpërndarë helmin e mediokritetit? Ndonëse plumbi del me plumb, dhe po, edhe ky shkrim ka trajtat e një vuajtje-ankese, fatkeqësisht, me shpresën e vetme për të shërbyer si një reflektim për çdo qytetar, për çdo shqipfolës, për çdo shkrimtar të ri, të cilët kanë potencialin të shkatërrojnë e rindërtojnë një literaturë të re, shpresëdhënëse dhe perëndimore, sepse nëse Petro Nini Luarasi, At Gjergj Fishta, Naim Frashëri, Nënë Tereza e shumë personalitete të tjerë kontribuuan për këtë komb dikur, nuk qenka e mundur sot? E ardhmja është e tashmja, mjafton vetëm të lexohen premisat (!) dhe si e tashme e ardhme është detyrë primordiale e qenies njerëzore krijimi i oazës individuale, së pari, e më pas kjo oazë injektohet në mënyrë natyrale në shoqërinë tonë, duke e bërë mendësinë të shokohet, të ndryshojë formë, harmonizohet dhe unifikohet, duke e bërë humanizmin të triumfojë përballë mediokritetit. Dija është çelësi! E ardhmja qëndron përpara syve tanë, e shëmtuar dhe cinike, por jo absolute për sa kohë shpresa ndriçon sado pak. Nuk është formulë e pa dëgjuar më parë, por është formulë e risjellë sërish e sërish për të reflektuar, së pari për individin, së dyti për shoqërinë e së tashmes dhe të së ardhmes. Ky vend është i bekuar në pasuri natyrore e në figura, të cilat kanë dhënë jetën për këtë vend. Ja vlen sado pak të jemi kontribuues të atdheut tonë! Është kjo shtysë e cila duhet të na udhëheqë për të ruajtur cilësinë e jetesës në këtë vend, nëpërmjet procesit empirik të gjithsecilit prej nesh, por dhe nëpërmjet procesit shpirtëror i cili mban emrin art. Nuk është e nevojshme të risillet definicioni i artit në këtë shkrim, por është e nevojshme të sulmohet çdo grimcë mediokriteti, të cilat duan të njollosin artin. E kur them sulm, i referohem të vërtetës, asaj së cilës shumë i frikësohen dhe e konsiderojnë sulm. Në morinë e shumtë të lavdërimeve fallce e të pashoqe, këta pseudo-intelektualë po injektojnë akoma dhe më shumë mediokritetin

në shoqëri. Përparim Kabo në librin e tij Antropologjia e frymës na paraqet tablonë e përçudnimit të historisë nga pushtetarët, por në të njëjtën kohë, na paraqet edhe anën tjetër të medaljes: përqeshjen që historia i bën këtyre njerëzve sapo ata bien nga pushteti. Historia mbetet aty, kujtesa po ashtu. Është gjithçka çështje kohe. Ndonjëherë miklimi artificial i shndërron këta njerëz në mbinjerëz, në kuptimin më të keq të fjalës. Reflektimi për këtë kategori është i pamundur. E gjithë kjo vorbullë miklimi-mungesë reflektimi vjen si pasojë e egos së tepruar, e kjo ego e tepruar vjen si pasojë e mungesës së dijes. Si një dorë e padukshme arti i kulluar të nxjerr nga ajo vorbullë nihilizmi për ta parë këtë vorbull, tani nga lart, me një epërsi. Epërsinë që të jep humanizmi. Arti është hyjnor dhe si i tillë le të kryejë misionin e tij. Le të jetë shëmbëlltyra e Krijuesit, forcës supreme!

Librat motivues dhe lexuesi i ri shqiptar

Sa më pranë lirisë së madhe të të shprehurit e të komunikuarit të jemi, aq më larg thelbit, farës ekzistenciale të të komunikuarit do të jemi. Arti i të komunikuarit është një grimcë hyjnore që e mban të lidhur ngushtë qenien njerëzore me Universin. Pa këtë grimcë hyjnore do të kishim qenë një tjetër kategori e familjes së madhe të kafshëve. Çfarë ndodh nëse ky art përjeton një transformim artificial të qëllimit të tij primordial? Ndodh pikërisht fenomeni më i përhapur i shekullit XXI: Materializimi i komunikimit demagogjik me rrënjë të ngulitura thellë në kotësinë e pragmatizmit duke bërë të mundur që peshorja të anojë nga e majta në të djathtë dhe kurrë më (deri më tani) të mos jetë në ekuilibër. Ky pohim i ri mbi qëllimshmërinë e komunikimit do të merej si i mirëqenë për mbarëvajtjen në harmoni të njerëzimit me ligjet universale vetëm në rastin kur një fenomen i ri (antitezë) nuk do të lulëzonte: Dëshira e zjarrtë e lexuesve të rinj drejt librave motivues.
Një zhaner "i ri" (në emërtim) letrar po zhvendos, njëri pas tjetrit, letërsinë "e vjetër". Pyetja që shtrohet, në të njëjtën kohë dhe epiqendra e këtij punimi është:
Ç'fshihet pas këtij zhaneri të ri që po lulëzon e po sugjestionon këta të rinj në mbarë botën?
Le ta nisim këtë rrugëtim me fazën e parë të kërkimit: Le të evidentojmë të paktën pesë titujt më të famshëm të këtij zhaneri dhe cila filozofi implikohet së tepërmi në këto pesë vepra.
Pesë titujt më të lexuar në mbarë botën janë:
1."Mendo dhe pasurohu" nga Napoleon Hill i cili nuk citon në mënyrë të drejtëpërdrejtë filozofë klasik por vëmë re një përdorim i ideve të ngjashme me stoicizmin dhe idealizmin amerikan.

2."Forca e zakonit" nga Charles Duhigg i cili mbështetet në shkencën e sjelljes dhe psikologji duke u ndërkallur herë pas here me ide të David Hume (rreth zakonit) dhe William James.
3."Jeto me qëllim" ngq John C. Maxwell i cili ndikohet nga mendimi etik dhe filozofia praktike. Edhe pse nuk citon filozofë klasikë në mënyrë direkte, mund të lidhet me mendimin e Aristotelit mbi qëllimin dhe virtytin.
4."Bëhu ai që je i thirrur te jesh" nga Robin Sharma i cili përmend shpesh filozofi lindore si Budizmi dhe Taoizmi si edhe aludon në figura si Sokrati dhe Seneka përmes ideve, jo gjithmonë me citime direkte.
5."Mendja e qetë, zemra e hapur" nga Dalai Lama i cili përdor filozofi budiste por edhe ide nga Kant, Schopenhauer dhe etikë universale të filozofisë perëndimore.
Nëse ky zhaner i ri letrar (le të përdorim këtë terminologji) po i afron njerëzit, mbi të gjitha të rinjtë, pranë leximit vlen për të shtruar pyetjen, edhe pse retorike, se nga se është e përbërë struktura (apo shtylla kurrizore) e këtij hipnotizuesi magjibërës (zhaneri të ri letrar). Siç e vumë re më sipër pjesa përbërëse e këtyre librave, esenca e tyre, është *filozofia si një nevojë e shpirtit*. Definimet e filozofisë janë të pafundme. Secili prej nesh mund të krijojë një definim të ri për filozofinë. Definicioni më i përshtatshëm që unë do të përzgjidhja për këtë punim do të ishte:
"Filozofia është si një antidot ndaj hidhërimeve që na kaplojnë në mes të sipërfaqesisë shqetësuese me të cilën përballemi para çështjeve te rëndësishme dhe ndaj boshllëkut e ankthit që shkakton mungesa e deshifrimit të çelësave të ekzistencës sonë." CITO
Termi filozofi në ditët e arta të epokës moderne ka një keqinterpretim të definimit primordial i cili tanimë dhe në vazhdim do të serviret si interpretimi apo definicioni absolut. Filozofia apo të filozofuarit serviret nën petkun e eufemizmit si një gjendje deliri e cila e argëton individin i cili filozofon nëpërmjet "lojërave të fjalëve" për t'i bërë bisht destinacionit final, qëllimit, të famshmit Maksimizimit të fitimit. A ju ka ndodhur dhe ju të dëgjoni: Lëri filozofirat?! Ma merr mendja se po!
Dëshira, e kristalizuar në një punim shkencor, për të ndërkallur filozofinë si një nevojë imediate në çdo degë universitare erdhi si pasojë e një degradimi 'të padukshëm' pasojat e së cilit mëse të dukshme.
Nëse njerëzimi do të mendonte se modaliteti si fenomen sociologjik nuk paraprihet nga një shkak, do të jetonte një jetë të gjatë, të përgjumur dhe do të definohej gjallesë e morisë së gjallesave dhe jo njerëzim.
Vjen një moment në të cilin paradokset shkrihen dhe çelin sythe filozofike. Një ndër to, të cilin të gjithë e kemi vënë re por e kemi lënë të lirë për shkak të jetës sonë të shpejtë e kaotike është rikthimi i një forme moderne të seminarëve me qasje "holistike" (holistikë moderne) nën drejtimin e një mentori, i cili mban titullin *Life Coach.*
Ky mekanizëm në dukje i ri i rrugëtimit drejt vetërealizimit krijon në psikën e një studiuesi (ndoshta jo të gjithëve) një analogji me atë çka do të quhej interpretimi abstrakt i vlerave morale, e cila nuk është gjë tjetër veçse një interpretim i moralit si perfeksionizëm e cila nuk është gjë tjetër veçse etika

e vetërealizimit. Nga vetë fjala vetërealizim, perfeksionizmi apo kodi moral brenda nesh gjendet, kuptohet dhe interpretohet nga vetë ne. "Life Coaches" janë koshientë dhe u bëjnë të ditur klientelës së tyre se ata janë veçse shtysa e jashtme të vetëshpallur primordiale por nuk i bën ata të rëndësishëm në rrugëtimin individual të pjesëmarrësve në seminaret e vetëpërmirësimit. Ata "kryejnë" *sacrum officium* për të përmbushur misionin e tyre në dimesionin tokësor.
Përtej devijancave profane, ku çdo individ i cili posedon një profil me një sasi ndjekësish vetëshpallet një mentor jete, dëshiroj të ndalem në vatrën thithëse dhe "hipnotizuese" të kësaj forme të re vetëpërsosjeje, nëpërmjet tre pyetjeve:
1.Përse rilindi nevoja e seminarëve vetëpërsosës kaq vrullshëm duke ulur ndjeshëm kredibilitetin e institucioneve arsimore?
2.Përse "qytetarët e botës së letrave" po qëndrojnë indiferentë përballë kërkesës kaq të lartë të rinisë për librat motivues duke e prishur balancën e peshores?
3.Përse termi *Life Coach* në Shqipëri posedohet në shumicën e rasteve nga individë që notojnë nëpër ujërat e komercialitetit?
Le të jenë këto tre pyetje pararendëse e fazës së shqyrtimit dhe reflektimit ashtu siç dituria na e dikton.
Rikthimi i të rinjve drejt librit kaq vrullshëm e ethshëm, këtë herë drejt librave motivues, vlen të merret në konsideratë për tu trajtuar, mbase për të ndryshuar kahun e letërsisë shqiptare, arsimit e shumë institucioneve të tjera. Karakteri kolerik (i prirur për tu zemëruar shpejt) i një pjese të madhe të shkrimeve, pasojat e së cilës kanë ngjizur një letërsi dhe një mentalitet i cili frymon nga barku i ankesës (për të cilën shpresojmë që të jetë një foshnjë e cila nuk do të jetojë gjatë) nuk mund të ndryshojë rrjedhën e letërsisë drejt harmonizimit social-kulturor. Zemërimi për hir të ndryshimit është ndër fazat e para të vetëpërmirësimit. Secili nga ne ka të dokumentuar një shkrim me karakter kolerik! Tejkalimi i kësaj faze në letërsinë shqiptare nuk mund të sjellë asgjë tjerër veçse pasojave pozitive. Zëvendësimi i letërsisë "së zemërimit" me letërsinë natyrale (e cila rrjedh nga fjala natyrë) ku notat dominuese të saj janë heshtja nga ku burojnë idetë, dashuria nga ku buron harmonia njerëzore dhe qëndrueshmëria (koherenca dhe kohezioni) nga ku burojnë ligjet e natyrës (ose ligji apo rregulli nga ku buron ekzistenca) do të ishte një hap drejt stabilitetit letrar dhe kulturor.
Le të jetë ky punim sado pak nxitës për rimëkëmbjen e të ardhmes së kulturës shqiptare dhe tjetërsimin (ose rikthimin) e kësaj shoqërie, në atë të dikurshmen, siç mua më pëlqen ta quaj, në shoqërinë naimiane.

Pyetjet kërkimore / metodat shkencore të aplikuara

Ky punim trajton tre pyetje kërkimore:

1. Në çfarë mase letërsia bashkëkohore shqiptare pasqyron kalimin nga një moral dogmatik (i “skllavit”) drejt një morali afirmues dhe individualist (i “mjeshtrit”)?
2. A mund të konsiderohet rritja e interesit për librat motivues si një formë e re e rezistencës ndaj moralit tradicional?
3. A përfaqësojnë shkrimtarët modernë shqiptarë një qasje më stoike, ekzistencialiste apo spirituale në letërsi, krahasuar me shkrimtarët e periudhës komuniste?

Metodologjia cilësore-krahasimore: Metoda krahasimore e përdorur në këtë kërkim shkencor është krahasimi empirik nëpërmjet dy anketave të realizuara: Anketë drejtuar 15 mësuesve/pedagogëve dhe shkrimtarëve si përfaqësues të një gjenerate e cila e ka jetuar sistemin komunist dhe anketë drejtuar 50 të rinjve si përfaqësues të një gjenerate e cila sintetizon dijen dhe lirinë e zgjedhjes.

Analiza e të dhënave

Sipas dy anketave të zhvilluara me 50 të rinj dhe 15 shkrimtarë dhe pedagogë kemi përftuar këto të dhëna:

ANKETA NR.1

Fig.1 Rezultatet e pyetjes: Cilin lloj letersie preferojnë më shumë të rinjtë sot?

Fig.2 Rezultatet e pyetjes: A vëreni rritje të leximit të librave motivues tek të rinjtë?



Fig.3 Rezultatet e pyetjes: Çfarë i tërheq më shumë të rinjtë te librat motivues?



Fig.4 Rezultatet e pyetjes: A mendoni se librat motivues nxisin mendimin kritik?

Fig.5 Rezultatet e pyetjes: Si do ta pershkruanit thelbin ideologjik te letërsisë shqiptare gjatë komunizmit?

A mendoni se kalimi nga letërsia moralizuese e së kaluarës tek librat motivues tregon:
15 responses
46.7%
33.3%
20%
Një liri më e madhe në zgjedhje
Një krizë të identitetit kulturor
Një nevojë shpirtërore jodogmatike

Fig.6 Rezultatet e pyetjes: A mendoni se kalimi nga letërsia moralizuese e së kaluarës tek librat motivues tregon:



Fig.7 Rezultatet e pyetjes: A jane librat motivues nje reagim ndaj boshllekut që ka lënë letersia propagandistike?



Fig.8 Rezultatet e pyetjes: A duhet të rikthehet letërsia si mjet formimi filozofik në shkolla?



Fig.9 Rezultatet e pyetjes: Cili eshtë roli i mësuesit/ shkrimtarit në drejtimin e lexuesit të ri?

ANKETA NR.2



Fig.1 A ke lexuar ndonjë vepër shqiptare që ka ndikuar në menyrën si mendon për jetën?



Fig.2 A ndihesh i/e përfaqësuar nga temat që trajtohen në letërsinë shqiptare moderne?



Fig.3 Sipas mendimit tënd, çfarë duhet të ofrojë letërsia shqiptare e sotme?

Fig.4 A mendon se librat motivues po zëvendësojnë letërsinë artistike te të rinjtë?

A mendoni se kalimi nga letersia moralizuese e se kaluares tek librat motivues tregon:
50 responses
36%
32%
32%
Nje liri me e madhe ne zgjedhje
Një krize të identitetit kulturor
Një nevojë shpirtërore jodogmatike

Fig.5 A mendoni se kalimi nga letërsia moralizuese e së kaluarës tek librat motivues tregon:



Fig.6 Cili eshtë roli i mësuesit/ shkrimtarit në drejtimin e lexuesit të ri?



Fig.7 A jane librat motivues nje reagim ndaj boshllëkut që ka lënë letersia propagandistike?


Çfarë libri po lexoni aktualisht? (Titulli dhe autori)
27 responses
Fuqia e se tashmes (Eckhard Tolle)
Erich Fromm Gjuha e Harruar
Hamleti Shekspiri
"Babai i pasur, babai i varfer" nga Robert T. Kiyosaki
Emanuel kanti , Paqja e perhershme
Franz kafka metamorfoza
Dalai Lama


Kush do te qaje kur te vdesesh , Robin Sharma
G.garcia marquez 100 vjet vetmi
Ryan Holiday , pengesa eshte rrugedalja
Mendo dhe pasurohu Napoleon hill
Mbreti lir shekspiri
Albert kamy miti i sizifit
Terapisti B. A. Paris
200 sekretet e suksesit Robin Sharma
Nje fund pa fillim

Fig.8 Çfare libri po lexoni aktualisht? (Titulli dhe autori)



Fig.9 Cilën lloj letersie preferojnë më shumë të rinjtë sot?

Këto rezultate tregojnë se të rinjtë sot nuk e kërkojnë më letërsinë për qëllime estetike, morale apo shprehëse, por për funksion praktik dhe përfitim personal. Dominimi i librave motivues/vetëzhvillues tregon një zhvendosje nga morali i “skllavit” drejt një morali të “mjeshtrit” — pra, nga bindja dhe nënshtrimi ndaj vlerave të përcaktuara nga tradita (si në letërsinë klasike), drejt vetëformimit, afirmimit individual dhe kontrollit

mbi fatin personal. Nga ana tjetër, përqindja e konsiderueshme që preferon letërsinë moderne/bashkëkohore tregon se ende ekziston një kërkim për autenticitet dhe reflektim social, por përmes një gjuhe më të lirë dhe eksperimentale sesa ajo klasike. Mungesa totale e interesit për letërsinë klasike sinjalizon rënien e vlerave të moralit tradicional, ku leximi shërbente si formë edukimi moral e shpirtëror. Rezultatet e sondazhit pasqyrojnë një transformim kulturor të brezit të ri, ku letërsia nuk është më mjet për "mësim" apo "moralizim", por për autonominë e individit. Kjo mbështet tezën e studimit se letërsia shqipe po lëviz drejt një morali të mjeshtrit, duke u fokusuar në vetëpërmirësim, zhvillim personal dhe afirmim të vlerave individuale.

Edhe pse shumica e të anketuarve pranojnë se ka një rritje të moderuar në leximin e librave motivues, vetëm një pakicë e vogël e sheh këtë si rritje të ndjeshme. Kjo tregon se interesi për literaturën motivuese është real, por jo domethënës në masë absolute — pra, trendi ekziston, por nuk është ende dominues. Në kuptimin filozofik të studimit, ky rezultat mund të interpretohet si fazë kalimtare nga morali i "skllavit" (pasiv, imitues) drejt moralit të "mjeshtrit" (aktiv, krijues). Të rinjtë po e kërkojnë vetëpërmirësimin, por shpesh në mënyrë të ndërmjetme — "deri diku" — që tregon një ndarje të brendshme midis dëshirës për emancipim dhe mungesës së plotë të vetëbesimit kulturor. Ky trend sinjalizon se lexuesi i ri po kërkon tek libri jo më modelin moral apo estetik të autorit klasik, por udhëzime praktike për përballimin e realitetit. Letërsia shqipe, për të qenë aktuale, duhet të zhvendosë narrativën nga viktimizimi dhe morali i vuajtjes drejt vetëpërmbushjes, pavarësisë dhe krijimit të kuptimit personal.

Dominimi i alternativës "fokusimi te vetja dhe suksesi personal" tregon një kalim të qartë nga morali i nënshtrimit (i "skllavit") drejt moralit afirmues e krijues të "mjeshtrit", sipas konceptit nietzschean. Të rinjtë nuk e lexojnë më librin si formë përvetësimi të një morali të gatshëm, por si mjet për vetëafirmim dhe ndërtim të identitetit personal.

Ndërkohë, përqindja e ndikimit të rrjeteve sociale sugjeron që ky orientim individualist ushqehet edhe nga kultura digjitale, e cila e promovon vetërealizimin si vlerë supreme. Kjo forcon ideologjinë e "njeriut si projekt", tipike për moralin e mjeshtrit — ku individi është krijues i vetvetes. Letërsia motivuese shihet nga të rinjtë si instrument për fuqizim personal dhe rritje të vetëdijes, jo si mjet moralizimi. Ky është tregues i një etape të re në raportin midis lexuesit shqiptar dhe

tekstit letrar: nga morali i vartësisë dhe imitimit drejt moralit të krijimit dhe zotërimit të vetvetes.

"'Njih vetveten', kjo është e tërë shkenca. - Nuk eshtë se njeriu, kur të ketë njohur të gjitha gjërat, atëherë mund të njohë vetveten. Sepse gjerat nuk janë veçse kufijtë e njeriut." (Nietzsche 2004)

Rekomandime/Përfundime

Në përfundim, kërkimi evidenton se letërsia shqipe ndodhet në një pikë kthese historike dhe shpirtërore. Nga një letërsi që shpesh ka reflektuar moralin e skllavit — pra, nënshtrimin dhe frikën— ajo duhet të orientohet drejt moralit të mjeshtrit, ku krijimtaria bëhet akt i vetëdijes, lirisë dhe përgjegjësisë.

Siç thekson Erich Fromm (1951), edukimi i vërtetë nuk është përshtatje me realitetin ekzistues, por proces çlirimi nga automatizmi dhe nga strukturat e frikës. Ai shkruan se “arti dhe edukimi janë mënyra për të mësuar të dëgjosh gjuhën e harruar të shpirtit” (Fromm, 1951). Kjo nënkupton se letërsia, për të qenë e ardhshme dhe emancipuar, duhet të rimarrë këtë funksion themelor — të risjellë në qendër njeriun si qenie krijuese dhe ndjesore. Në të njëjtën linjë, Hermann Hesse (1943) në Loja e rruazave prej qelqi sheh artin dhe dijen si një proces të përhershëm përkushtimi ndaj harmonisë shpirtërore. Ai shprehet se “çdo mjeshtëri e vërtetë është një mënyrë për t’u bërë një me universin” (Hesse, 1943), duke sugjeruar se mjeshtria nuk është vetëm zotërim teknik, por një formë e lartë etike dhe estetike e qenies. Kështu, letërsia shqiptare e së ardhmes duhet të synojë këtë dimension — një letërsi që nuk imiton, por formon; që nuk përshtatet, por krijon. Në këtë kuptim, edukimi përmes artit bëhet themeli i transformimit moral dhe estetik. Vetëm një kulturë që kultivon mendimin e pavarur, ndjeshmërinë dhe aftësinë për vetëreflektim mund të lindë shkrimtarë dhe lexues “mjeshtërorë”. Siç do të thoshte Fromm, njeriu që krijon është ai që “e sheh botën jo si një objekt për t’u zotëruar, por si një proces për t’u kuptuar dhe dashur” (Fromm, 1951).

REKOMANDIME

1. Riformulimi i qasjes arsimore ndaj letërsisë në shkolla dhe universitete, duke kaluar nga analiza dogmatike te interpretimi krijues dhe kritik. Edukimi letrar duhet të nxisë përvojën estetike dhe etike si një formë ndërtimi të vetëdijes.

"Vlerësimi tepër i ulët i arsimit të gjimnazit. - Rrallë kërkohet vlera e gjimnazit në gjërat që përvetësohen realisht aty dhe nga fakti se, në gjimnaz, ato merren pa mundur të humbasin më, por kërkohet në gjërat që mësohen aty, të cilat nxënësi i përvetëson pa deshirë për t'i shkundur nga vetja sa më shpejt që të mundet. Leximi i klasikëve - çdo person i arsimuar e pranon këtë - në mënyrën në të cilën kryhet ngado, është një procedurë e përbindshme: para te rinjve, që nuk janë pjekur ende nga asnjë pikëpamje për këtë lexim, dalin mësues që me çdo fjalë, madje shpesh edhe me pamjen e tyre, hedhin një shtresë mielli mbi një autor të mirë. Por vlera e gjimnazit që zakonisht nenvlerësohet qëndron te kjo, që keta mesues flasin gjuhën abstrakte të kulturës më të lartë, të ngadalteë dhe të veshtirë për t'u kuptuar, ashtu si është ajo, por që është një gjimnastikë e lartë për mendjen; që në gjuhën e tyre shfaqen vazhdimisht ide, shprehje artistike, metoda, aludime, te cilat të rinjtë nuk i degjojnë pothuajse kurrë në bisedat e zhvilluara në familje apo në rrugë. Edhe pse nxënësit vetëm dëgjojnë, intelekti i tyre formohet herët, në menyrë të pavullnetshme, përmes një menyre të vëzhgimit shkencor. Nuk është e mundur të dalesh nga kjo disiplinë krejtësisht i paprekur nga abstraksioni, si bij të paster të natyrës." (Nietzsche, 1878)

2. Përkrahja e autorëve të rinj që eksplorojnë tema të lirisë, vetëdijes, dhe transcendencës, duke ndihmuar që letërsia shqiptare të rifitojë dimensionin e saj të vërtetë humanist.

3. "Herë dukej se djali dëshmonte nderim e bindje ndaj moshës, autoritetit e dinjitetit, herë dukej sheshit se ai mishërim rinie, fillese e gjallërie, që ecte me hap të lehtë përpara tij, e detyronte plakun t'i shkonte pas plot bindje e admirim. Dhe, ndersa po rrinte e veshtronte atë rrotullame ëndrrash, të pakuptimshme e kuptimplotë, ënderruesi kishte ndjesinë sikur njejtësohej herë me plakun e herë me djalin, sikur ishte herë adhurues e herë i adhuruar, herë udhërrëfyes e herë pasues i bindur, ndërsa gjatë këtyre këmbimeve fluturake erdhi një çast kur ai ishte edhe njëri edhe tjetri, në të njejtën kohë Mjeshtri dhe shkollari i vogël, madje më fort qëndronte sipër të dyve, qe nismëtari, krijuesi, timonieri e spektatori i asaj rrotullameje, i asaj gare te kotë vrapimi qarkor midis pleqërisë e rinisë. Dhe nga ky proces lindi një nocion i ri, më fort simbol sesa fantazi, më fort konkluzion sesa shembëlltyrë, domethëne nocioni ose me fort konkluzioni se ajo rrotullame e pakuptimshme e kuptimplotë e Mjeshtrit dhe e nxënësit, ajo deshire e urtësisë per të fituar rininë, ajo deshirë e rinisë për të fituar urtësinë, ajo lojë e pafund e flatërore qe përgjithësisht loja e jetës, që rrjedh e pasosur, e ndarë në pleqëri e rini, në ditë e natë, në Jang e Jin." (Hesse,1943)

Nëse arsimi dhe kultura shqiptare do të arrijë të çkodojë këtë alegori të Hermann Hesse-s, do të arrijë të krijojë një shoqëri më të mençur e më në harmoni me rendin hyjnor.